



**UNIVERSITETI I EJK
JHE YHIBEP3ITET
SEE UNIVERSITY**

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

(Master of Arts)

TITULLI I PROGRAMIT:

STUDIME PËR TË DREJTËN KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

H Y R J E

FAKULTETI JURIDIK

1. Institucioni/organi për dhënien titullit	Universiteti i EJL-së
2. Institucioni arsimor	Universiteti i EJL-së
3. Vendi i mbajtjes së mësimit	Kampusi i UEJL-së (Tetovë)
4. Program i akredituar nga:	Këshilli i akreditimit
5. Grada finale shkencore	M.A.
6. Programi	Studime për të drejtën kushtetuese dhe administrative
7. Data e përpunimit/revizionit	Shtator 2007
8. Grupi i studentëve	Gjenerata e vitit akademik 2008/2009
9. Qëllimet mësimore të programit	

10. Deri në mbarimin e programit, studentët do të pajisen me njohuri dhe do t'i kuptojnë të gjitha segmentet e sferës të së drejtës kushtetuese dhe administrative, siç janë: liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të shtetasit, e drejta kushtetuese, e drejta administrative, e drejta kushtetuese e krahasuar, siguria publike, kontrolli gjyqësor i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, e drejta e punës dhe e drejta e sigurimit social, e drejta administrative procedurale, shkenca e administrimit, sistemi politik, e drejta e vetadministrimit lokal, teoritë dhe doktrinat bashkëkohore politike, partitë politike dhe grupet e interesit, procesi zgjedhor dhe modelet zgjedhore, filozofia e së drejtës, si dhe rregullat dhe parimet kyçe, të cilat janë relevante për perspektivën e tyre teorike dhe praktike.
11. Me sukses t'i zbatojë njohuritë e fituara për të drejtën kushtetuese dhe administrative në shumë situata ku shqyrtohen problemet e rëndësishme teorike dhe praktike;
12. T'i vlerësojë problemet në bazë të kontekstit, relevancës dhe rëndësisë së tyre dhe t'i ndërlihdh informacionet relevante dhe fjalët kyçe të ofruara përmes këmbimit elektronik të të dhënave dhe mënyrave tjera;
13. T'i vlerësojë problemet dhe të gjejë zgjidhje lidhur me zbatimin e njohurive, parimeve dhe rregullave kushtetuese-administrative në Republikën e Maqedonisë dhe më gjerë, në kontekst krahasimtar, mandej t'i formulojë argumentet për problemet kryesore dhe çështjet kontraverze, duke e prezantuar me këtë rast mendimin racional, të mbështetur në materialin relevant shkencor;
14. T'i njohë argumentet potenciale alternative dhe dëshmitë kundërshtuese sipas mendimit të vetë dhe t'i vë në dukje ato; të demonstrojë shprehje të lirë dhe aftësi që të ofrojë nxitje kritike për njohuritë e fituara për probleme individuale dhe në fund, të reflektojë në mënyrë pozitive për progresin shkencor.

1. Rezultatet e nxënies së mësimit

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE TË SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

Cikli i dytë i këtij programi do të ofrojë njohuri solide dhe me kuptim të sistemuar të strukturave institucionale të funksionimit organeve qendrore të pushtetit shtetëror, për parimet kyçe juridiko-politike, si dhe aspektet themelore të sferës së të drejtës kushtetuese dhe administrative.

Njohuritë e fituara

Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit të cilat përdoren për arritjen dhe prezentimin e rezultateve

A. Njohuritë e fituara dhe shqyrtimet e programit:

1. Ky program do t'ju mundësojë studentëve fitimin e shkathtësive për ballafaqimin problemet juridike lidhur me funksionimin e shtetit dhe se drejtes, duke e nxitur tek ata zhvillimin e vetëdijes së tyre kritike.

2. Do t'i nxisë studentët të bëjnë komente burimore dhe të avancuara, të cilat i plotësojnë standardet e larta shkencore dhe akademike dhe do t'ju ndihmojë në zhvillimin e shkathtësive kritike, analitike dhe hulumtuese, të cilat megjithatë, do të mund të zbatohen në çështjet konkrete të kësaj sfere.

3. Programi është strukturuar me qëllim zhvillimit të shkathtësive, posaçërisht përmes prezantimit me gojë dh me shkrim të argumenteve shkencore në frymën, e cila i integron në vete rregullat relevante akademike, duke u ndihmuar me këtë rast, edhe atyre studentëve të cilët mendojnë për vazhdimin ndërtimit të tyre akademik në nivel më të lartë.

Ligjëratat/mësimi

Shkathtësitë e numëruara intelektuale do të zhvillohen para së gjithash nëpërmjet përgatitjes dhe pjesëmarrjes në seminare, dhe shumë pak përmes leksioneve klasike dhe formale, përkatësisht përmes mësimit interaktiv. Kjo mundëson që politikat dhe interpretimet e ndryshme të së drejtës dhe shtetit të studiohen në mënyrë kritike, kurse pozicionet alternative të vlerësohen në mënyrë krahasimtare.

Prezantimi i seminareve mund në mënyrë të plotë të orientohet në ato segmente të së drejtës kushtetuese-administrative, të cilat lejojnë hapësirë për diskutim dhe debate dhe për të cilat ekziston interes përkatës. Në vazhdim, vlerësimi i lëndës i lejon dhe i nxit diskutimet dhe prezantimet e avancuara të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat e shprehjes akademike.

Vlerësimi

Vlerësimi i njohurive të fituara nga lëndët do të bëhet në mënyrë të kombinuar, përmes provimeve me shkrim (kolokuiume dhe provimi final), eseve të përbërë prej 4000 deri më 500 fjalë, të cilat patjetër duhet të dorëzohen për çdo lëndë të ndjekur. Pjesa tjetër e programi

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE TË SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

4. Ky program do të jetë me rëndësi të veçantë për ata kandidatë të cilët do ta vazhdojnë karrierën e tyre në sferën kushtetuese-administrative.

kërkon nga. Pjesa tjetër e programit kërkon nga studentët të hulumtojnë, të shkruajnë dhe ta dorëzojnë disertacionin e bërë prej 15.000 deri më 20.000 fjalë, pas caktimit paraprak të temës nga fusha e së drejtës kushtetuese-administrative, nën mbikëqyrjen e një anëtari të kuadrit akademik me përvojë nga fusha përkatëse.

B. Shkathtësitë dhe karakteristika tjera

Aftësitë për barten e shkathtësive intelektuale. Ligjëratat/mësimi

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

1. Me hulumtimin dhe përgatitjen tezës së magistraturës t'i zhvillojnë shkathtësitë hulumtuese dhe të fitojnë njohuri individuale progresive.

2. Të nxiten të zhvillojnë një nivel të lartë, të sofistikuar shkencor përmes tezave të tyre dhe, njëkohësisht të vijnë në shprehje në tezën e shkruar të magistraturës.

Ligjëratat do të ndiqen nëpërmjet tri orëve të seminare, të cilat do të mbahen çdo të dytën javë. Në fillim të ligjëratave, ligjëruesi do ta paraqes kontekstin e përgjithshëm të lëndës dhe ekspozonë e problemeve kyçe dhe do t'i vë në dukje sferat për të cilat do të diskutohet gjatë orëve të mësimi. Këtë hyrje që do ta gjejnë studentët në literaturën e rekomanduar, ka për qëllim t'i fokusojë seminarët në diskutime të hollësishme për tema të caktuara, thjeshtë të bazuara në prezantime dhe ese nga ana e studentëve dhe aplikimi i diskutimeve për probleme të së drejtës kushtetuese-administrative. Prezantimet kërkojnë nga studentët të formojnë pikëpamjet e tyre për fushën përkatëse dhe të zhvillojnë diskutime me ligjëruesin dhe me kolegët.

<p>C. Zbatimi i shkathtësive speciale: Aplikimi dhe zgjidhja e rastit juridik. Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:</p> <p>a) T'i njohin çështjet juridike të cilat dalin nga si rezultat i gjendjes faktike të kompleksitetit, të definuar në të drejtën ndërkombëtare dhe në atë maqedonase;</p> <p>b) T'i identifikojnë rastet në bazë të përvojave të mëparshme juridike;</p> <p>c) Të sigurojnë mendim shkakor dhe informim të mirë të veprimeve të mundshme ligjore, të cilat dalin nga ky mendim, si dhe mundësitë e suksesit.</p>	<p>Ligjëratat/mësimi</p> <p>Vlerësimi Aftësia për zgjidhjen e problemeve juridike kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në orët e këtij programi.</p> <p>Pas seminareve të mbajtura në gjuhën angleze nga ana e kuadrit ndërkombëtar, studentët për së afërmi njihen me metodat mësimore juridike të lejuara në vendet e Europës Perëndimore dhe universitetet amerikane</p> <p>Vlerësimi Vlerësimi bëhet në pyetjet e shtruara rreth lëndës konkrete në provimin me shkrim dhe në vlerësimin e lëndës, duke i përfshirë edhe testet në orë.</p>
---	---

Burimet, hulumtimet, dhe vlerësimi	
<p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:</p> <p>a) T'i identifikojnë çështjet juridike dhe çështjet tjera të ngjashme që duhet të studiohen;</p> <p>b) T'i përdorin në mënyrë efikase burimet primare dhe sekondare;</p> <p>c) Të bëjnë studim të pavarur juridik, duke përdorur një varg burimesh;</p> <p>ç) Ta vlerësojnë në mënyrë kritike sferën e të drejtës kushtetuese-administrative, si nga aspekti i doktrinës, po ashtu edhe nga aspekti shoqëror;</p> <p>d) Të zhvillojnë nivel të lartë, të sofistikuar shkencor përmes tezave të tyre dhe, njëkohësisht mundëson që shkathhtësitë e ndryshme të studentit të vijnë në shprehje në tezën e shkruar të magistraturës.</p>	<p>Vlerësimi</p> <p>Vlerësimi i lëndës dhe disertacionit.</p>

Ç. Shkathtësitë kryesore:

Komunikimi dhe shkrimi

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët aftësohen:

a) ta përdorin gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze me shkrim dhe gojarisht, lidhur me çështjet rreth sferës kushtetuese-administrative;

b) Të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe efikase në dëshmitë dhe diskutimet për çështjet komplekse në gjuhën shqipe, maqedonase dhe në gjuhën angleze;

c) Të bëjnë një prezantim të qartë dhe koherent për ndonjë temë dhe detyrë, duke përdorur materiale të ndryshme;

ç) Të lexojnë materiale komplekse, të cilat janë, ose nuk janë të lidhura me sferën kushtetuese-administrative.

Ligjëratat/mësimi

Punimet e seminarit, prezantimet në orë, diskutime. Përgatitjet, të shkruarit dhe reflektimi nga vlerësimi i lëndës së shkruar, duke e përfshirë edhe disertacionet.

Vlerësimi

Vlerësimi i lëndës së shkruar, vlerësimi i prezantimeve në orë, si dhe realizimi i punës së vlerësuar praktike. Provimi me gojë dhe me shkrim.

11. Struktura e programit studimor, kushtet e studimit, niveli, moduli, kreditë dhe mirënjohjet

Studime pasuniversitare nga fusha e së drejtës penale do të zgjasin (2) vite akademike, përkatësisht tre semestra, të përbërë nga pesë lëndë dhe një semester teza e magistraturës. Lëndët në semestra janë të obligueshme, ndërsa të tjerat janë zgjedhore. Çfo lëndë e dëgjuar, dhe me sukses është kaluar në provim, studentit do t'i sjell 6 (gjashtë) kredi, kurse teza e magistraturës do t'i sjell 30 kredi. Kjo donë të thotë se për kryerjen me sukses të studimeve pasuniversitare janë të nevojshëm 120 kredi. Secila lëndë duhet të kryhet duke i plotësuar edhe kërkesat e shtruara në silabusin (programin) e lëndës.

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE TË SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

PROGRAMI STUDIMOR PËR TË DREJTËN KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/Vëror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze	6	D	22	22	180	
Metodologjia e së drejtës	6	D	22	22	180	
E drejta kushtetuese	6	D	22	22	180	
E drejta administrative	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/Vëror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria	6	V	22	22	180	
Partitë politike dhe grupet e interesit	6	V	22	22	180	
E drejta procedurale administrative	6	V	22	22	180	
Filozofia e së drejtës	6	V	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	V	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/Vëror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
E drejta e punës dhe e drejta e sigurimit social	6	D	22	22	180	
E drejta e vetadministrimit lokal	6	D	22	22	180	
E drejta parlamentare	6	D	22	22	180	
Siguria publike	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 4</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/Vëror</i>	<i>Orët</i>	<i>Orët</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Madhësia</i>
-------------------	----------------	----------------------	-------------	-------------	-----------------	-----------------

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE TË SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

	<i>itë</i>	<i>ëror/ Veror</i>	<i>teorike</i>	<i>prakti ke</i>	<i>Orët studimore</i>	<i>e grupeve</i>
Shkrimi i tezës	30	V			900	
Gjithsej	30				900	

Lëndët zgjedhore:

- E drejta zgjedhore
- E drejta kushtetuese e krahasuar
- Teoria dhe praktika e federalizmit
- Të shkruarit dhe të menduarit juridik

PËRSHKRIMI I LËNDËVE OBLIGATIVE

SEMESTRI 1

Metodologjia e së drejtës

Metodologjia e së drejtës i studion metodat e njohjes së të drejtës dhe llojet e saj, si dhe metodat e krijimit, interpretimit dhe zbatimit të së drejtës, që janë të nevojshme për procesin hulumtues në të gjitha sferat juridike dhe në të gjitha nivelet e arsimit akademik.

E drejta kushtetuese

E drejta kushtetuese i thellon njohuritë e studentëve me natyrën e normave kushtetuese, lëndën e rregullimit dhe vlerave të tyre të cilat janë object i mbrojtjes së tyre. Në këtë lëndë më gjëresisht mësohen çështjet lidhur me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, si dhe organizimin e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë që, megjithatë janë elemente themelore të përmbajtjes së kësaj lënde. :

E drejta administrative

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE TË SË DREJTËS KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

E drejta administrative i studion parimet e organizimit, punës dhe fushveprimit të orgganeve administrative, veprimtaritë themelore që e përbëjnë funksionin administrativ, aktet e organeve administrative, marrëdhëniet midis qytetarëve dhe shtetëror dhe administrate, marrëdhëniet e administrates me politikën, ligji dhe administrimi, tendencat themelore bashkëkohore të organizatave administrative, si dhe reformat në administratën publike dhe kompatibiliteti I tyre me të drejtën europiane.

SEMESTRI 2

Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria

Lënda Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria studion kontrollin gjyqësor t kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si komponentë esenciale të gjyqësisë kushtetuese. Kjo lëndë siguron njohuri më të thelluara për sistemet, llojet, modelet dhe format e kontrollit gjyqësor, duke u bërë një vështrim krahasimtar përkatës.

Partitë politike dhe grupet e interesit

Lënda partitë politike dhe grupet e interesit i studion partitë politike dhe grupet e interesit, grupet subjektet parlamentare dhe grupet të cilat e japin orientimin konkret të realizimit të aktiviteteve politike në punën dhe veprimin e institucioneve të sistemit

E drejta procedurale administrative

Kjo lëndë studion procedurën e përgjithshme administrative, parimet, sjelljen e vendimeve, procedurën e ankimit, procedurën e mjeteve të jashtëzakonshme juridike dhe kontrollin administrativo-gjyqësor.

Filozofia e së drejtës

Lënda Filozofia e së drejtës i studion metodat filozofike, analogjinë e së drejtës, marrëdhëniet midis së drejtës pozitive dhe objektive, aksiologjikë e së drejtës dhe gnoseologjinë e së drejtës, duke bërë të njohur posaçërisht vlerat juridike dhe marrëdhëniet midis moralit, zakonit dhe së drejtës gjatë historisë dhe sot.

SEMESTRI 3

E drejta e punës dhe e drejta e sigurimit social

E drejta e punës dhe e drejta e sigurimit social e studion punën e rregulluar juridikisht, përkatësisht themelimin e marrëdhënies së punës, të drejtat, ndërprerjen, mbrojtjen e të drejtave dhe përgjegjësinë e punëtorëve. Gjithashtu, studion edhe çështjen e papunësisë dhe të sistemeve të mbikëqyrjes së punës. Pjesa e dytë, studion sigurimin social (sigurimin shëndetësor, të pensionit dhe sigurimin invalidor), duke i inkorporuar në vete çështjen sociale, e cila në esencë është humanitare dhe bazohet në parimin e drejtësisë komulative, si dhe në reformat në tri shtyllat dhe kompatibilitetin e tyre me të drejtën evropiane.

E drejta e e vetadministrimit lokal

Lënda E drejta e vetadministrimit lokal e studion organizimin, funksionimin, parimet, strukturat, metodat, nocionet themelore dhe modelet teorike të vetadministrimit lokal, si dhe marrëdhëniet midis pushtetit qendror dhe lokal në Republikën e Maqedonisë dhe më gjerë në kontekst krahasimtar dhe evropian, me ç'rast rëndësi i kushtohet Kartës evropiane të vetadministrimit lokal.

E drejta parlamentare

E drejta parlamentare si disiplinë shkencore juridiko-politike merret me studimin e demokracisë parlamentare dhe sistemeve parlamentare në aspektin teorik, krahasues, politik dhe praktik, tranzicionin e shteteve të Europës Juglindore, si dhe sistemet parlamentare në Republikën e Maqedonisë, Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Itali, Gjermani, Bullgari, Rumani, Hungari, Shqipëri dhe vene tjera.

Siguria publike

Lënda siguria publike merret me studimin e strukturave, sistemeve dhe formave të sigurisë publike, si dhe procesin e tyre reformues, me qëllim të integritimit në NATO dhe në EU.

PËRSHKRIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE

E drejta zgjedhore

Lënda zgjedhore E drejta zgjedhore i studion zgjedhjet dhe sistemin zgjedhor në aspekt historik dhe krahasimtar, marrëdhëniet midis sistemit zgjedhor dhe sistemit partiak në Republikën e Maqedonisë dhe UE-së, si dhe reformat në procesin zgjedhor në RM, me qëllim të integritimit në NATO dhe në UE.

E drejta kushtetuese e krahasuar

Lënda zgjedhore E drejta kushtetuese e krahasuar i studion aspektet krahasimtare të sistemeve kushtetuese të vendeve të UE-së dhe më gjerë, me qëllim të sigurimit të njohurive më të thelluara për parimet dhe për funksionimin e institucioneve kyçe të pushtetit shtetëror në aspekt krahasimtar.

Teoria dhe praktika e federalizmit

Lënda Teoria dhe praktika e federalizmit ju ofron studentëve njohuri për organizimin e shteteve federale, organet, kompetencat e tyre, llojet e shteteve, disa federata karakteristike në botë, si dhe për çështje teorike qendrore dhe praktike lidhur me shtetet federale, siç janë: Kushtetuta e shtetit federal, përbërja-struktura e federatës, ndarja e kompetencave midis federatës dhe subjekteve të saj, pjesëmarrja e subjekteve të federatës në kryerjen e pushtetit federal, e drejta e vetorganizimit të subjekteve të federatës, çështja e sovranitetit (shtetësia) në shtetin federal, perspektivat e federalizmit në botë, si dhe çështja e pozitës së njësive federale në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Të shkruarit dhe të menduarit juridik

Lënda zgjedhore Të shkruarit dhe të menduarit juridik është lëndë praktike, karakteristike për sistemin amerikan të arsimit juridik, e cila i studion rregullat dhe parimet themelore të hartimit të shkrimit juridik në të gjitha institucionet e shtetit dhe arsyetimi i tyre me shkrim, ndërsa ka për qëllim zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të shkrimit dhe të oratorisë.